

RAPORT TEKNIK



Objekti : Rikonstruksion Rruga Okshatine
Bashkia Bulqize

Autor i Projektit
“ERALD - G” shpk

VITI - 2019

PERMBAJTJA E RAPORTIT TEKNIK

1. TE PERGJITHSHME

- 1.01 Hyrje**
- 1.02 Vend Ndodhja e objektit**
- 1.03 Gjendja Egzistuese**


2. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

**Projekti i Rruges
Veprat e Artit**

3. PREVENTIVI I PUNIMEVE

**Preventivi me Çmime
Preventivi pa Çmime**

4. SPECIFIKIMET TEKNIKE



1. TE PERGJITHSHME

1.01 Hyrje

Me porosi te Bashkise Bulqize, eshte realizuar Projekt-Zbatimi per rrugen e fshatit Okshatine, qe lidh kete fshat me rrugen nacionale Peshkopi - Tirane.

1.02 Vend Ndodhja e Objektit

Objekti “Rikonstruktion Rruga Okshatine”, ka nje gjatesi rreth 712 ml , dhe nje rrugice lagje (ne drejtim te shkolles) me 71 m gjatesi.

1.03 Gjendja Aktuale e Objektit

Objekti aktualisht paraqitet ne nje gjendje jo te mire, ku gjate periudhes qe bien shira dhe reshje bore veshtiresohet se tepermi, pasi rruga eshte vetem ne trasene egzistuese ku asnjehere nuk jane bere nderhyrje per rikonstruktion te saj. Pra ne kete rruge mungojne plotesisht shtresat rrugore dhe elementet e infrastruktures rrugore.

Sistemi i KUSH : mungon plotesisht. Ujrat rrjedhin ne trup te rruges, ne forme siperafaqesore sipas pjerresive natyrale te vete rruges, pasi kanalet anesore mungojne plotesisht. Tombionot Egzistuese thuaje jane pa puseta e portale.





2. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

Projekti i Rrugeve

Rruga e Fshatit Okshatine, eshte projektuar ne perputhje me kerkesat e percaktuara nga Bashkia Bulqize. Ajo do te kete nje gjeresi te pergjithshme prej 5m ne pjesen hyrese te fshatit dhe 3m ne pjeset ku jane muret rrethuese te shtepive (sipas projektit) , dhe do te perbehet nga :

- trupi i rruges me gjeresi 5m / 3m
- pjesa e asfaltuar me dy pjerresi terthore, 4m / 3m
- dhe ne te dyja anet bankine me gjeresi 2x0.50 m (ne segmentin me asfalt 4m)

Ne pjesen ne germim gjate gjatesise se rruges do te kete kanal anesor, per ujrat e shirave.

Rruga e projektuar ruan pergjithesisht aksin e rruges egzistuese duke bere permiresimet e mundshme gjeometrike te rruges.

- Shtresat ne trup te rruges

Paketa e plote e shtresave rrugore e percaktuar nga studimi i kryer do te permbaje keto shtresa :

- asfaltobeton 4 cm
- binder 6 cm
- stabilizant 15 cm
- çakell natyral 20 cm

Kjo pakete e shtresave rrugore do të ndertohet pasi të jenë bërë punimet e germim-mbushjeve të niveletës së rrugës, dhe pasi trupi i rrugës (bazamenti) të jetë cilindruar. Shtresa e parë do të shërbejë edhe si shtresë profiluese e rrugës.

Projekti i Kanalizimeve dhe i Ujrave të Shirave

Rrjeti i kullimit të ujrave të shiut do të përbehet nga kanalet anësore të rrugës, në pjesën e germimit, pusët dhe portalet e tombinave si dhe tubacionet dhe betoni dhe celiku që do të ndertohen në trupin e rrugës.

Tubacionet do të plotësojnë të gjitha standartet në fuqi dhe në projektin e zbatimit jepen të gjitha normat dhe specifikimet e nevojshme. Kjo vlen edhe për të gjitha materialet e tjera që do të përdoren.

Pusët dhe tombinave do të kenë dimensione të ndryshme, kjo në varesi të terrenit dhe të dimensionit të tubit të tombinave.

Do të ndertohen pusët dhe portalet dhe në disa tombina egzistuese.

Projekti i Sinjalistikës Rrugore

Në projektin e sinjalistikës rrugore është parashikuar Sinjalistika Horizontale dhe ajo Vertikale.

- **Sinjalistika Horizontale** përbehet nga :

1. Vijezi
- a) Vijezi do të bëhet në të dy anët e pjesës së asfaltuar, me gjerësi 15 cm secila.
- b) Në zonat pranë degezimeve dhe kryqezimeve rrugore, do të vijëzohet me vije të ndërprera.

- **Sinjalistika Vertikale** përbehet nga :

1. Tabelat treguese

Shenim : Projekti i Sinjalistikës, gjatë zbatimit të objektit, mund të ndryshohet nga Bashkia Bulqize.

**“ERALD – G” Sh.p.k.
ADMINISTRATOR**

Ing. Gezim ISLAMI

